

Të nderuar zotërinj,

Në emër të **Vil Oil Sh.A & ALPET**, kam kënaqësinë të konfirmoj edhe një herë mbështetjen tonë për parimet e Kompaktit Global lidhur me:

1. Të drejtat e njeriut
2. Të drejtat në lidhje me marrdhëniet e punës
3. Mbrojtjen e Mjedisit
4. Anti-korrupsionin

Me anë të kësaj deklaratë ne shprehim mbështetjen tonë për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre parimeve. Ne marrim përsipër ta bëjmë iniciativën e Kompaktit Global dhe parimet e përfshira në të, pjesë aktive të strategjisë, të kulturës dhe të parimeve tona të biznesit.

Bashkangjitur do të gjeni një përmbledhje të punës që kemi bërë lidhur me parimet e përmendura më lart, të cilat do të vazhdojnë të jenë pjesë e punës sonë në vazhdimësi.

Me respekt,

Dr. Ibrahim AKTOZ

Administrator i Përgjithshëm

RAPORT PROGRESI

Vil Oil Sh.A & ALPET

Web: www.alpet.al

Tel: +355 4 2221 666/177

Fax: +355 4 2253 451

e-mail: info@alpet.al

ALPET është një nga 9 ndërmarrjet e ndryshme të shoqërisë turke **Altinbas Holding** e themeluar në Turqi. Aktiviteti në tregun shqiptar të karburanteve nis në fillimet e vitit 2005, kur kompania turke **ALPET**, hyri në tregun shqiptar si një brand nëpërmjet shoqërisë **Vil Oil sh.a.** Sot në Shqipëri, duke filluar nga Shkodra në Sarandë dhe nga Durrësi në Korçë, numërojmë rreth 100 pika karburanti **ALPET** në vendet më strategjike të Shqipërisë. Në këto pika tregtojmë produktet e cilësisë më të mirë: **EURO 5** Diezel 10ppm, **EURO 4** Diezel 50ppm, **Super 95** Oktan, **Ultra Force** 100 Oktan. Në vitin 2007 kompania ALPET është klasifikuar si kompania më e suksesshme në fushën e karburanteve. Kjo kompani operon në treg me certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2000. Objektivi ynë është që së shpejti marka **ALPET** të jetë e pranishme dhe në tregjet e Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Celësi i suksesit tonë të menjëhershëm, përveç investimeve të mëdha, është dhe cilësia e padiskutueshme e produkteve që ne ofrojmë.

ALPET, bashkëpunon me **UNDP** që prej vitit 2007 dhe beson që ka bërë pjesë së strategjisë së saj principet e **Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara**.

TE DREJTAT E NJERIUT – Parimi 1 dhe Parimi 2

1. Biznesi duhet të mbeshtese dhe të respektoje të drejtat e njeriut te njohura ne menyre universale sipas konventave nderkombetare.

2. Biznesi duhet të siguroje qe nuk behet pale ne shkeljen e te drejtave te njeriut.

Kompania ALPET ka të punësuar mbi 500 punëtorë në ushtrimin e aktivitetit të saj, duke respektuar parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të gjitha ligjet e vendit në lidhje me marrdhëniet e punës. ALPET kujdeset që ambientet e punës dhe kushtet e tyre të plotësojnë

të gjitha standartet e duhura për punonjësit, që ata të ndihen të motivuar në punën e tyre. Në të gjitha stacionet e karburanteve ALPET respektohen standartet teknike dhe rregullat e sigurisë dhe të gjithë punonjësit tanë janë të trajnuar në kontrollin kundër zjarrit, ndihmën e shpejtë dhe vetmbrojtje sikurse edhe në ruajtjen e standarteve të sigurisë në cdo veprim.

PUNA – Parimi 3, Parimi 4, Parimi 5 dhe Parimi 6

3. Bizneset duhet të njohin të drejtën për tu organizuar dhe të njohin efektivisht të drejtën për të negociuar në mënyrë kolektive.

4. Eliminimi i të gjitha formave të punës së detyruar.

5. Zhdukja e punës së fëmijëve.

6. Eliminimi i diskriminimit në punësim.

Në zyrat e administratës sonë vihet re një mbizotërim i punësimit të gjinisë femërore, kurse për nga vetë natyra jo e përshtatshme e punës me 3 turne dhe e qëndrimit pranë pompave të furnizimit, në pikat e tregtimit të karburanteve gjenden të punësuar meshkuj. Këta të fundit janë të moshave dhe u përkasin komuniteteve të ndryshme racore e fetare, duke u respektuar kështu parimi i mosdiskriminimit në punë për shkak të moshës, fesë apo racës. Por gjithmonë duke iu përmbajtur kufirit të ligjit për mospunësimin e të miturve nën moshën 16 vjeç.

Kompania ALPET gjatë gjithë viteve të ushtrimit të aktivitetit të saj në Shqipëri ka ndërmarrë iniciativa që kanë të bëjnë me përgjegjësitë sociale ndaj komunitetit. Por ne po fokusohemi nga viti 2007 e në vazhdim. ALPET ka dhënë ndihmë në ushqime e dhurata pranë shtëpisë së fëmijës Zyber Hallulli dhe ka mbështetur me ndihma financiare shumë shoqata në mbështetje të fëmijëve jetimë. Në muajin gusht të vitit 2008, nën kujdesin e ALPET rreth 100 fëmijë jetim nga Tirana dhe Fushëkruja pushuan për dy javë në ambientet e kompleksit Tropikal në Durrës. Për ta u shtrua dhe një drekë në praninë e Drejtorit të Përgjithshëm, **Z.Ibrahim AKTOZ**. Gjithashtu me rastin e Festimeve për ditën e Bajramit, ALPET dhuroi pako me ushqime për familjet e varfra të qytetit të Peqinit. Gjatë vitit 2008 ALPET ka financuar dhe ndërtimin e një këndi lojrash për shtëpinë e fëmijëve jetimë të qytetit të Shkodrës. Disa ditë përpara fillimit të vitit të ri shkollor, në shtator 2008, ALPET i dhuron disa prej fëmijëve të Mirditës, cantën e tyre të shkollës si dhe pako me ushqime. Për festat e fundivitetit, ALPET në bashkëpunim me kompaninë MERINOS dhe me mbështetjen e Ambasadës Turke në Tiranë, shpërndau 200 pako me veshmbathje dhe

ushqime për 200 fëmijë jetimë të qytetit të Pogradecit. Në ditën ndërkombëtare të jetimëve, ALPET dhe kompania e telefonisë celulare EAGLE Mobile në bashkëpunim me Kompleksin TAIWAN, dhe me praninë e Znj. Liri Berisha, bënë të mundur që mbi 100 fëmijë jetimë nga Tirana, Durrësi e Elbasani të kalojnë ditën e tyre duke u argëtuar në ambientet dhe lojrat e këtij kompleksi. Për ta u shpërndanë dhe pako me dhurata dhe u organizua një bufë e hapur. Këto janë vetëm disa nga nismat e kompanisë ALPET e cila vazhdimisht jep ndihmën e saj për shtresat më në nevojë në shoqëri.

ALPET nuk ka munguar as në sponsorizimin e projekteve të shumta artistike e sportive të organizuara në vend si Festivali Ndërkombëtar i Vokalit Operistik Marije Kraja, Rally Albania, ndeshje sportive etj. Tashmë prej disa vitesh jemi sponsor të ekipit të futbollit të Dinamos. Me rastin e Festës së 8 Marsit 2009, Kompania organizoi një drekë për 50 kliente femra të ALPET të cilat, u përzgjedhën me anë të një shorteu. Në këtë festë ishin të ftuar dhe personazhe të njohur të ekranit.

MJEDISI – Parimi 7 Parimi 8 dhe Parimi 9

7. Bizneset duhet të mbeshtesin një perqasje parandaluese për sfidat e mjedisit.

8. Te ndermarin nisma për nxitjen e një përgjegjshmerie me të lartë ndaj ceshtjeve të mjedisit.

9. Nxitja e zhvillimit dhe përhapjes së teknologjive që mbrojnë mjedisin.

Një nga principet kryesore të ALPET është vlerësimi që i bëhet mjedisit. Kjo në mënyrë të dukshme vihet re dhe në ngjyrat ALPET, e gjelbër dhe blu, ngjyrat e florës dhe faunës. Kujdes i vecantë i kushtohet gjelbërimit të ambienteve në të gjitha stacionet tona duke pasqyruar respektin tonë ndaj natyrës. Ne jemi krenarë të përmendim faktin që jemi të parët që i kemi ofruar konsumatorit shqiptar Ultra Force 100 Oktan (lloj benzine pa plumb) si dhe EURO 5 Diezel 10 ppm, eurodiezeli me përqindjen më të ulët të squfurit në karburant i cili përveç performancës së lartë që i ofrojnë konsumatorit, ndikojnë ndjeshëm në uljen e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Ne dimë që përmbajtja e squfurit në karburant është e lidhur me clirimin nga motorri i makinës i gazrave të dëmshëm në atmosferë duke përfshirë këtu: monoksidin e karbonit, hidrokarburet e padjegura, oksidin e nitrogjenit, dioksidin e karbonit dhe nxjerrjen e blozës së zezë. Produktet që ne ofrojmë kanë përqindje minimale të squfurit, i cili ndikon pikërisht në mos clirimin e këtyre gazrave të dëmshëm që ndotin mjedisin. ALPET gjithashtu, ka

qënë kompania e parë në tregun shqiptar të karburanteve, që në stacionet e saj nuk ka ofruar më D2 (EURO 2), kjo që përpara daljes së ligjit nga qeveria shqiptare që ndalon tregtimin e këtij lloj diezeli. Të gjitha produktet tona janë brenda standarteve të pranuar nga Komuniteti Europian.

ANTI-KORRUPSIONI – Parimi 10

10. Bizneset duhet te punojne se bashku kunder te gjitha formave te korrupsionit duke perfshire mitemarrjen dhe mitedhenien.

ALPET ka bashkëpunuar me partnerë seriozë në ushtrimin e aktivitetit tregtar dhe respekton ligjet e vendit lidhur me fushën ku vepron. Gjithashtu ALPET respekton konkurrencën e lirë dhe të ndershme.

ALPET & Vil Oil Sh.A do të vazhdojë të respektojë dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të Kompaktit Global.